



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:259736

Datë: 17.09.2024

Numri i dokumentit: 06172719

C-IV.-14-6611

Ankuesi :

K R nga f.sh R K.Shtime.
Përfaqësuar nga D B avokat nga Ferizaji .

Kundër

E paditura :

N.SH “Eurometal” -Ferizaj, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.05 shtator 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. APROVOHET** ankesa e ankuesit si e bazuar dhe **NDRYSHOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.GJI057-0188 dt.17 korrik 2013.
- 2. OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit K R në emër të kompensimit për paga të papaguara t’i paguaj **shumën prej 1,043.00€**.
- 3.** Shuma e aprovuar si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushet në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.
- 4. OBLIGOHET** e paditura që ankuesit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej **124.00€**.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.21 tetor 2014, ankuesi përmes të autorizuarit të tij dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. GJI057-0188 dt.17 korrik 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin për pagat e pa paguara në shumë prej 1,398.00 €, nga NSH “Eurometal” Ferizaj (në likuidim). Ankuesi pohoi se e kundërshtoi vendimin e AL për shkak se ka qenë në marrëdhënie të punës tek NSH “FAKNIT” dhe se pa bazë ligjore nuk i janë paguar të ardhurat personale prej majit deri në muajin tetor të vitit 1990, ndërsa në muajin nëntor ankuesit me punëtorët e tjerë janë larguar në mënyrë arbitrare. Ka shtuar se pas largimit nga puna ka ushtruar padi në Gjykatën kompetente kundër vendimit mbi largimin nga puna dhe për pagesën e pagave, duke përfshirë pagesën e pagave të pa paguara. Ka kërkuar që padia e tij të aprovohet si a bazuar. Të njëjtës i ka bashkangjitur këto prova: Regjistri i punëtorëve për realizimin e borxhit të NSH “Faknit” të mbetur të mbetur në vitin 1990 për muajt Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, nr.08 dt.27.03.2006, Propozim drejtuar Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar, informata e nr.114 dt.07.05.1991, Kopjen e vendimit të kundërshtuar.

Me dt.01 gusht 2024 gjykata ka lëshuar një urdhër për ankuesin përmes të cilit ka kërkuar që të bëjë dorëzimin e provave shtesë në mbështetje të pretendimeve ankimore. I autorizuari i ankuesit me dt.13 gusht 2024, i është përgjigjur urdhrin përmes parashtrësës duke bërë dorëzimin e këtyre provave: kopjen e librezës së punës, Informatat nr.3142 dt.02.10.1990 nr.1128 dt.05.05.1991 të lëshuara nga NSH “Faknit”, Ferizaj, Propozim drejtuar Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar, Ftesa për shqyrtim nga Gjykata Themelore e Punës së Bashkuar nr.1391 dt.10.10.1991 për propozuesin A I, Një shkresë e shkruar me dorë, Regjistri i punëtorëve për realizimin e borxhit të NSH “Faknit” të mbetur të mbetur në vitin 1990 për muajt Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, nr.677 dt.04.07.2002, Njoftimi i Eurometal nr.0032/2013/IN dt.10.05.2013, Ankesë për Gjykatën e Qarkut Prishtinë në lëndën C.nr.71/2005, Aktvendimi Ac.nr.251/2006 dt.21.01.2008, Njoftimi i lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj GJ.A.nr.328/2022 dt.21.10.2022, Njoftimin e lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj GJ.A.nr.414/2019 dt.10.05.2013.

Me dt.25 korrik 2024 ankuesi e ka parashtruar në gjykatë një parashtrësë, me të cilën i ka kërkuar shpenzimet e procedurës sipas Tarifës së Avokatëve.

E paditura parashtrroi përgjigje në ankesë me dt.26 gusht 2024 në të cilën pohoi se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. Vendimi i AL nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore dhe se nuk ka asnjë bazë për ta shfuqizuar duke e theksuar rregullin se ankuesi e ka barrën e provës dhe se i njëjti nuk e ka paraqitur vendimin e gjykatës që i kërkohej përmes kërkesës për informacione shtesë, andaj edhe kërkesa ka mbetur e pa plotë. E paditura propozoi që ankesa të Refuzohet si e pa bazuar. Mbrojtjes i ka bashkangjitur kopjen e vendimit të kundërshtuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i Autoritetit të Likuidimit.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par. 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, par.3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Neni 14.1 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës) parasheh që: “*Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës*”. Neni 55.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit) parasheh që: “*I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit*”.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH “Faknit” tani “Eurometal” në Ferizaj. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e të provuarit se a i ka mbetur NSH borxh paga të pa paguara ankuesit. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta nuk është dëshmuar me prova, me arsyetim se ankuesi nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm. E paditura nuk e ka kontestuar lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në provat e dorëzuara me ankesë dhe me parashtrësën e dt.13 gusht 2024.

Nga njoftimi Ref.nr.Gj.A.nr.414/2019 dt.10.05.2013 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, vërtetohet se lëndët me të cilat punëtorët kanë kërkuar aktgjykim nga Gjykata

Themelore në Ferizaj, ishin të regjistruara dhe të pa kryera. Kurse nga njoftimi Ref.nr.Gj.A.nr.328/2022 dt.21.10.2022 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, vërtetohet lënda të cilën e ka kërkuar i autorizuari i ankuesit gjendet në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Me kopjen e propozimit për pagimin e të ardhurave personale drejtuar Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar vërtetohet se në mesin e propozuesve gjendet edhe emri i ankuesit K R. Kurse me regjistrin e punëtorëve për realizimin e borxhit të mbetur pranë NSH “Faknit” për muajt maj – tetor 1990, e cila përmban vulën e NSH “Eurometal” me nr.08 dhe dt.27.03.2006 vërtetohet se në mesin e punëtorëve gjendet emri i ankuesit K R, ku specifikohet shuma e cila i takon prej 1.068.00€. Ky regjistër është i nënshkruar nga Kryetari i punëtorëve - S.V, Drejtori K - Q.Q dhe Financat - H.A.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara provat e elaboruara më lart, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën maj – tetor 1990 dhe se për këtë periudhë i takon kompensimi për paga të papaguara në shumë prej 1,043.00€, ashtu siç i ka kërkuar me padi. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur apo se nuk i takon kompensimi për paga.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1,043.00€, gjykata është bazuar në faktin se lartësinë të cilën e ka kërkuar pala me kërkesën drejtu AL si dhe me regjistrin e punëtorëve të cilëve iu takojn pagat e pa pagurara për periudhën maj- tetor 1990, e paditura fare nuk e ka kundërshtuar në mbrojtjen e saj. Andaj, duke qenë se lartësia e kërkesës së palës nuk ishte kontestuese në mes të palëve në procedurë gjykata e mori si të besueshme, dhe ia fali besimin.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vjen në përfundim se ankuesi K R, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për paga të papaguara në shumën e aprovuar.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjyqimit.

Shpenzimet gjyqësore

Ndaj parashtruesit të ankesës nuk caktohet taksë gjyqësore ngase të njëjtën e ka paguar më dt.22.07.2024 në shumë prej 20 euro, sipas Udhëzimit Administrativ të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr. 01/2017 të datës 1 maj 2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

E paditura është e obliguar ti paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 124.€ ashtu që , në bazë të Rregullores së Tarifës së Odës së Avokatëve, në shumat prej: 104.00€ për ankesë si dhe 20.00€ për taksën gjyqësore.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtarja
Hajrie Shala